REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI CIVIL

Nr. 90100-03372-00-2018 i Regj.Themeltar
Nr. 00-2018-1229 i Vendimit

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

Xhezair Zaganjori	Kryesues
Ardian Dvorani	Anëtar
Edmond Islamaj	Anëtar

Në dhomën e këshillimit të datës 27.12.2018, mori në shqyrtim çështjen që u përket palëve:

KËRKUES: SEKCUK SENCER ESENYEL

PERSON I TRETË: SHOQËRIA "TRADE MINIRALS AL" SH.P.K

OBJEKTI:
Marrjen e masës provizore të sigurimit të padisë, bllokimin e të gjitha llogarive bankare, të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme të personit të tretë "Trade Minerals AL" sh.p.k. si dhe aseteve të kësaj shoqërie, duke bllokuar asetet dhe kuotat e kësaj shoqërie në Qëndrën Kombëtare të Biznesit (QKB), deri në masën që mbulojnë objektin e shumës e cila do të kërkohet në padinë që do të ngrihet në Gjykatën e Arbitrazhit Ndërkombëtar të Londrës (LCIA).

BAZA LIGJORE: Nenet 32, 154/a, 202, 204 dhe 206 etj, të K.Pr.Civile.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. s'ka, datë 06.08.2018 ka vendosur:

"1.Nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor të çështjes civile me Nr. Regj. Them. 749, datë 03.08.2018.
2. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës kërkuese. 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim i veçantë brenda 5 ditëve nga dita e nesërme e vendimit të arsyetuar në Gjykatën e Lartë."

Kundër këtij vendimi, me datë 14.09.2018, ka paraqitur ankim të veçantë kërkuesi Selcuk Esenyel. Rezulton se vendimi i arsyetuar i është njoftuar përfaqësuesit me prokurë të kërkuesit av. Rudi Laze me datë **23.10.2018**. Në ankim janë parashtruar këto shkaqe:

- *Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është i pabazuar në ligj;*
- *Sipas nenit 203 dhe 204 të K.Pr.Civile gjykata ka kompetencë për marrjen e masave të sigurimit të padisë edhe para ngritjes së padisë në gjykatën e vendit ku ka banimin paditësi ose ku ndodhet pasuria me të cilën do të sigurohet padia;*
- *Duke patur parasysh që debitori "Trade Minerals AL" sh.p.k. është subjekt i të drejtës tregtare shqiptare, me seli në Tiranë, gjykatë kompetente për vendosjen e masave të sigurimit të padisë është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë;*
- *Në rastin konkret kërkesa për marrjen e masës së sigurimit të padisë, jo vetëm që është e bazuar në prova, por është në përputhje me frymën e nenit 202 të K.Pr.Civile;*
- *Marrja e masës së sigurimit në rastin konkret do të bënte efektiv ekzekutimin e vendimit të dhënë nga Gjykata e Arbitrazhit Ndërkombëtar të Londrës e zgjedhur vullnetarisht nga palët si gjykata kompetente për zgjidhjen e çdo mosmarrëveshjeje midis tyre. Kjo pasi është fakt i mirënjohur se procesi i hetimit gjyqësor në këtë gjykatë ka një kohëzgjatje të konsiderueshme dhe gjatë kësaj kohe personi i tretë mund të kryejë veprime abuzive me pasurinë e tij çka do të pamundësonte ekzekutimin e vendimit gjyqësor në të ardhmen;*
- *Ndryshe nga sa arsyeton Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, neni 204 i K.Pr.Civile nuk e lidh marrjen e masës së sigurimit të padisë domosdoshmërisht me ngritjen e padisë në një gjykatë shqiptare*
- *Në nenin 204 Ligjvënësi është shprehur se gjykata cakton një afat jo më shumë se 15 ditë për ngritjen e padisë në **gjykatë** dhe me termin gjykatë ligji nuk vendos ndonjë kufizim nëse kemi të bëjmë me ndonjë gjykatë shqiptare apo të huaj. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e interpreton në mënyrë të gabuar këtë dispozitë dhe e kufizon marrjen e masës së sigurimit të padisë nga një gjykatë shqiptare vetëm nëse padia e themelit do të shqyrtohet nga një gjykatë shqiptare. Kjo bie ndesh me parimin se ajo që nuk ndalohet shprehimisht me ligj është e lejuar;*
- *Është i gabuar arsyetimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë se në rastin konkret nuk mund të lejohet investimi i dy juridiksioneve të ndryshme për të disponuar për të njëjtën natyrë kërkimi. Kjo pasi kërkimi për marrjen e masës së sigurimit të padisë është krejtësisht i ndarë nga kërkimet që lidhen me padinë e themelit. Në të kundërt, kjo do të binte ndesh edhe me Vendimin Unifikues nr. 10/2004, datë 24.03.2004 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, sipas të cilit gjykatat vendimin për marrjen e masës së përkohshme për sigurimin e padisë nuk duhet t'a mbështesin në fakte apo veprime që kanë të bëjnë me shqyrtimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjes në themel.*

Rezulton se ankimi i është njoftuar personit të tretë, shoqërisë "Trade Minerals AL" sh.p.k. me datë 29.10.2018, e cila me datë 05.11.2018 ka paraqitur kundërankim duke parashtruar këto shkaqe:

- *Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është i bazuar në ligj;*
- *Në pikën 13 të kontratës së lidhur me kërkuesin është parashikuar se çdo mosmarrëveshje që ka të bëjë me këtë kontratë do të zgjidhet nga Arbitrazhi në Londër sipas ligjit anglez;*
- *Klauzola e arbitrazhit për sa kohë është e vlefshme përjashton juridiksionin gjyqësor në shqyrtimin e mosmarrëveshjes;*
- *Marrëveshja për arbitrazhin ndërkombëtar në rastin konkret është në përputhje me Konventën "Për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit", në të cilën*

Republika e Shqipërisë ka aderuar me Ligjin nr. 8688,, datë 09.11.2000, e cila është burim i së drejtës, e detyrueshme për zbatim në Republikën e Shqipërisë;

- *Sipas nenit 418 të K.Pr.Civile (të shfuqizuar tashmë) gjykata e arbitrazhit kishte të drejtë të vendoste në lidhje me masat e sigurimit të padisë dhe vetëm nëse palët nuk e pranonin këtë masë atëherë gjykata e arbitrazhit mund t'i drejtohej gjykatave të zakonshme.*

KOLEGJI CIVIL I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarit, z. Ardian Dvorani, dhe si bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

I. Rrethanat e çështjes

1. Para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me datë 03.08.2018, është paraqitur një kërkesë për caktimin e një mase sigurimi padie.

2. **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. s'ka, datë 06.08.2018,** ka vendosur: "*1.Nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor të çështjes civile me Nr. Regj. Them. 749, datë 03.08.2018. 2. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës kërkuese. 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim i veçantë brenda 5 ditëve nga dita e nesërme e vendimit të arsyetuar në Gjykatën e Lartë.*".

3. Gjykata ka arsyetuar se palët kanë zgjedhur në kontratën e tyre edhe mënyrën se si do të zgjidhin mosmarrëveshjet që lindin nga ekzekutimi i saj, duke përjashtuar juridiksionin gjyqësor të shtetit Shqiptar dhe duke përcaktuar si forum jashtëgjyqësor kompetent Arbitrazhin në Londër dhe duke zgjedhur edhe ligjin anglez. Për rrjedhojë gjykata ka vlerësuar se gjykata shqiptare nuk ka juridiksion për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Gjykata ka sjellë në vëmendje se nenet 400 dhe 411 të Kodit të Procedurës Civile janë shfuqizuar dhe se të vetmet dispozita në fuqi janë ato të Konventës "*Për njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit*", e cila është ratifikuar me Ligjin nr. 8688, datë 09.11.2000 dhe përbën burim të detyrueshëm normativ. Gjykata ka vlerësuar se aktualisht nuk ka në fuqi një dispozitë ligjor që t'i japë juridiksion gjykatës shqiptare për masat e sigurimit të padisë të paraqitura para ngritjes së padisë, në rastet kur palët kanë zgjedhur arbitrazhin kombëtar apo ndërkombëtar për zgjidhjen e mosmarrëveshjes dhe për rrjedhojë gjykatat Shqiptare nuk mundet të ushtrojnë juridiksion në zgjidhjen e këtyre kërkesave. Gjykata ka konkluduar se nuk mundet të gjej zbatim as ligji për të drejtën ndërkombëtare private, pasi juridiksion nuk kanë gjykatat shtetërore të huaja, por ka gjykata e arbitrazhit.

4. **Kundër këtij vendimi, me datë 14.09.2018**, **ka paraqitur ankim të veçantë kërkuesi Selcuk Esenyel**. Rezulton se vendimi i arsyetuar i është njoftuar përfaqësuesit me prokurë të kërkuesit, av. Rudi Laze, me datë **23.10.2018**. Në ankim janë parashtruar këto shkaqe:

- *Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është i pabazuar në ligj;*
- *Sipas nenit 203 dhe 204 të K.Pr.Civile gjykata ka kompetencë për marrjen e masave të sigurimit të padisë edhe para ngritjes së padisë në gjykatën e vendit ku ka banimin paditësi ose ku ndodhet pasuria me të cilën do të sigurohet padia;*

- *Duke patur parasysh që debitori "Trade Minerals AL" sh.p.k. është subjekt i të drejtës tregtare shqiptare, me seli në Tiranë, gjykatë kompetente për vendosjen e masave të sigurimit të padisë është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë;*
- *Në rastin konkret kërkesa për marrjen e masës së sigurimit të padisë, jo vetëm që është e bazuar në prova, por është në përputhje me frymën e nenit 202 të Kodit të procedurës Civile;*
- *Marrja e masës së sigurimit në rastin konkret do të bënte efektiv ekzekutimin e vendimit të dhënë nga Gjykata e Arbitrazhit Ndërkombëtar të Londrës e zgjedhur vullnetarisht nga palët si gjykata kompetente për zgjidhjen e çdo mosmarrëveshjeje midis tyre. Kjo pasi është fakt i mirënjohur se procesi i hetimit gjyqësor në këtë gjykatë ka një kohëzgjatje të konsiderueshme dhe gjatë kësaj kohe personi i tretë mund të kryejë veprime abuzive me pasurinë e tij çka do të pamundësonte ekzekutimin e vendimit gjyqësor në të ardhmen;*
- *Ndryshe nga sa arsyeton Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, neni 204 i Kodit të Procedurës Civile nuk e lidh marrjen e masës së sigurimit të padisë domosdoshmërisht me ngritjen e padisë në një gjykatë shqiptare;*
- *Në nenin 204 Ligjvënësi është shprehur se gjykata cakton një afat jo më shumë se 15 ditë për ngritjen e padisë në **gjykatë** dhe me termin gjykatë ligji nuk vendos ndonjë kufizim nëse kemi të bëjmë me ndonjë gjykatë shqiptare apo të huaj. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e interpreton në mënyrë të gabuar këtë dispozitë dhe e kufizon marrjen e masës së sigurimit të padisë nga një gjykatë shqiptare vetëm nëse padia e themelit do të shqyrtohet nga një gjykatë shqiptare. Kjo bie ndesh me parimin se ajo që nuk ndalohet shprehimisht me ligj është e lejuar;*
- *Është i gabuar arsyetimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë se në rastin konkret nuk mund të lejohet investimi i dy juridiksioneve të ndryshme për të disponuar për të njëjtën natyrë kërkimi. Kjo pasi kërkimi për marrjen e masës së sigurimit të padisë është krejtësisht i ndarë nga kërkimet që lidhen me padinë e themelit. Në të kundërt, kjo do të binte ndesh edhe me Vendimin Unifikues nr. 10/2004, datë 24.03.2004 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, sipas të cilit gjykatat vendimin për marrjen e masës së përkohshme për sigurimin e padisë nuk duhet t'a mbështesin në fakte apo veprime që kanë të bëjnë me shqyrtimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjes në themel.*

5. Rezulton se ankimi i është njoftuar personit të tretë, shoqërisë "Trade Minerals AL" sh.p.k. me datë 29.10.2018, e cila **me datë 05.11.2018 ka paraqitur kundërankim**, duke parashtruar këto shkaqe:

- *Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është i bazuar në ligj;*
- *Në pikën 13 të kontratës së lidhur me kërkuesin është parashikuar se çdo mosmarrëveshje që ka të bëjë me këtë kontratë do të zgjidhet nga Arbitrazhi në Londër sipas ligjit anglez;*
- *Klauzola e arbitrazhit për sa kohë është e vlefshme përjashton juridiksionin gjyqësor në shqyrtimin e mosmarrëveshjes;*
- *Marrëveshja për arbitrazhin ndërkombëtar në rastin konkret është në përputhje me Konventën "Për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit", në të cilën Republika e Shqipërisë ka aderuar me Ligjin nr. 8688,, datë 09.11.2000, e cila është burim i së drejtës, e detyrueshme për zbatim në Republikën e Shqipërisë;*
- *Sipas nenit 418 të K.Pr.Civile (të shfuqizuar tashmë) gjykata e arbitrazhit kishte të drejtë të vendoste në lidhje me masat e sigurimit të padisë dhe vetëm nëse palët nuk e pranonin këtë masë atëherë gjykata e arbitrazhit mund t'i drejtohej gjykatave të zakonshme.*

II. Ligji i zbatueshëm

4. **Neni 31 i Kodit të Procedurës Civile** që parashikon se: *"Në juridiksionin e gjykatave hyjnë të gjitha mosmarrëveshjet civile dhe mosmarrëveshjet e tjera të parashikuara në këtë Kod e në ligje të veçanta"*

5. **Neni 37 i Kodit të Procedurës Civile** që parashikon se: "*Juridiksioni i gjykatave shqiptare për personat fizikë dhe juridikë të huaj rregullohet me ligj. Juridiksioni i gjykatave shqiptare nuk mund t'i kalohet me marrëveshje një juridiksioni të huaj, përveç kur gjykimi ka lidhje me një detyrim ndërmjet të huajve ose ndërmjet një të huaji e një shtetasi shqiptar, ose personi juridik pa banim ose qëndrim në Shqipëri, si dhe kur këto përjashtime janë parashikuar në marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë."*

6. **Neni 59 i Kodit të Procedurës Civile** parashikon se:"*Gjykata në çdo fazë dhe shkallë të gjykimit, qoftë edhe kryesisht, merr në shqyrtim nëse çështja që shqyrton, bën pjesë në juridiksionin gjyqësor apo atë administrativ. Kundër vendimit të dhënë për një rast të tillë, mund të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Lartë."*

7. **Neni 418 i Kodit të Procedurës Civile** parashikon se: "*Gjykata e arbitrazhit, me kërkesën e njërës prej palëve mund të vendosë marrjen e masave për sigurimin e padisë, përveç kur ka marrëveshje të kundërt ndërmjet palëve. Nëse palët nuk kanë vendosur rregulla për një qëllim të tillë, gjykata e arbitrazhit zbaton rregullat e parashikuara në këtë Kod për sigurimin e padisë. Nëse pala tjetër nuk zbaton vullnetarisht këto masa, gjykata e arbitrazhit i drejtohet gjykatës kompetente, e cila vendos sipas rregullave të caktuara në këtë Kod."*

8. **Neni 6/4 i Konventës Europiane mbi Arbitrazhin Tregtar Ndërkombëtar, Gjenevë, 21.04.1961 (**në të cilën Republika e Shqipërisë ka aderuar me Ligjin nr.8687, datë 09.11.2000, "*Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Europiane të Arbitrazhit*"), nën titullin "**Juridiksioni i Gjykatës**", parashikon se: "…*Një kërkesë për masa të përkohshme ose masa sigurimi që i është drejtuar një autoriteti gjyqësor, nuk mund të konsiderohet si e papajtueshme me marrëveshjen e arbitrazhit, as edhe si shtrim i thelbit të çështjes në gjykatë.*"

III. Vlerësimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë

9. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (në vijim) vlerëson se gjykata e shkallës së pare ka zbatuar gabim ligjin procedural, ka identifikuar gabim të drejtën e detyrueshme për t'u zbatuar dhe ka zgjidhur çështjen në kundërshtim me ligjin. Për rrjedhojë Kolegji vlerëson se vendimi duhet të prishet dhe çështja duhet të kthehet për vazhdimin e gjykimit në të njëjtën gjykatë dhe para të njëjtës trupë gjykuese.

10. Kolegji, ndryshe nga sa pretendohet në kundërankim dhe ndryshe nga sa arsyetohet në vendimin jopërfundimtar të gjykatës së shkallës së parë, konkludon se dispozitat e Kodit të Procedurës Civile mbi gjykimin në arbitrazh kombëtar dhe ndërkombëtar nuk janë shfuqizuar. Është e vërtetë që neni 30 i Ligjit nr. 122/2013 ka shfuqizuar dispozitat ligjore në Kodin e Procedurës Civile mbi arbitrazhin kombëtar dhe ndërkombëtar. Por ligji ndryshues duhet të lexohet dhe të

interpretohet të tërësi, duke pasur parasysh edhe klauzolat e hyrjes në fuqi. Gjykata e shkallës së pare nuk ka pasur parasysh pikërisht këto klauzola dhe ndaj vendimi është në kundërshtim me ligjin.

11. Neni 49 i Ligjit nr. 122/2013 ka parashikuar se neni 30 i tij - ai që shfuqizonte dispozitat mbi arbitrazhin në Kodin e Procedurës Civile – hyn në fuqi pas miratimit[1] të ligjit mbi arbitrazhin. Kjo do të thotë se neni 30 i ligjit ndryshues do të hynte në fuqi në momentin kur Kuvendi të miratonte dhe të hynte në fuqi ligji për arbitrazhin kombëtar dhe ndërkombëtar. Ky kusht ligjor zgjidhës nuk është vërtetuar akoma, pasi akoma nuk është miratuar dhe akoma nuk ka hyrë në fuqi ky ligj. Për rrjedhojë dispozitat e Kodit të Procedurës Civile mbi arbitrazhin kombëtar dhe ndërkombëtar nuk janë shfuqizuar dhe janë akoma në fuqi.

12. Kolegji vlerëson se masat e përkohshme procedurale në procesin civil kanë një natyrë të tillë juridike sa që, edhe pse palët kanë parashikuar forume gjyqësore apo jashtëgjyqësore të tjera për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, sërish ligji ka lejuar ushtrimin e juridiksionit të përkohshëm gjyqësor, duke u nisur nga urgjenca dhe rreziku eminent dhe egzigjencat për të garantuar mjete efektive mbrojtje për të drejtat subjektive civile. Pikërisht nga kjo *ratio* kushtetuese merr përmbajtje neni 418 i Kodit të Procedurës Civile, i cili parashikon se:

"*Gjykata e arbitrazhit, me kërkesën e njërës prej palëve mund të vendosë marrjen e masave për sigurimin e padisë, përveç kur ka marrëveshje të kundërt ndërmjet palëve.*

Nëse palët nuk kanë vendosur rregulla për një qëllim të tillë, gjykata e arbitrazhit zbaton rregullat e parashikuara në këtë Kod për sigurimin e padisë.

Nëse pala tjetër nuk zbaton vullnetarisht këto masa, gjykata e arbitrazhit i drejtohet gjykatës kompetente, e cila vendos sipas rregullave të caktuara në këtë Kod.".

12.1. Për më tepër, pikërisht nga kjo *ratio* ka marrë përmbajtjen edhe neni 6 pika 4 i Konventës Europiane mbi Arbitrazhin Tregtar Ndërkombëtar, ku nën titullin "**Juridiksioni i Gjykatës**", parashikon se:

"…*Një kërkesë për masa të përkohshme ose masa sigurimi që i është drejtuar një autoriteti gjyqësor, nuk mund të konsiderohet si e papajtueshme me marrëveshjen e arbitrazhit, as edhe si shtrim i thelbit të çështjes në gjykatë.*".

13. Këto dy norma juridike të gjithëpushtetshme bëjnë të konkludosh se pretendimet në kundërankim dhe arsyetimi i vendimit të gjykatës së shkallës së pare janë të pabazuara në ligj dhe në të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për zbatim (shih nenin 5 të Kushtetutës). Juridiksioni i gjykatave Shqiptare, apo kombëtare, në raport me juridiksionin e arbitrazhit ndërkombëtar është konkurues në momentin e shqyrtimit të kërkesave për mbrojtje të përkohshme procedurale. Ndaj gjykatat nuk mundet të refuzojnë të zbatojnë ligjin, nuk mundet të pengojnë realizimin e aksesit në gjykatë dhe ofrimin e mbrojtjes së përkohshme procedurale në këto raste. E njëjta logjikë juridike është ruajtur edhe në zgjidhjen ligjore që është parashikuar mbi këtë çështje edhe projektligji i propozuar për arbitrazhin ndërkombëtar, por që akoma nuk është miratuar.[2] Çështja që shtrohet për

[1] Këtu ligjvënësi ka një gabim material, pasi nuk mundet të shfuqizohet ligji pa hyrë në fuqi ligji pasues. Kjo do të thotë se termi i duhur kushtetues do të duhet të ishte "*me hyrjen në fuqi*" dhe jo "*me miratimin*", pasi nga pikëpamja e procesit kushtetues ligjvënës këto dy momente paraqesin pasoja të ndryshme juridike.

[2] Shih nenin 10 të projektligjit, i cili parashikon se:"*Nuk është në mospërputhje me marrëveshjen e arbitrazhit që secila nga palët pjesëmarrëse në një marrëveshje arbitrazhi, para ose gjatë gjykimit të arbitrazhit, të kërkojë nga gjykata marrjen e një mase paraprake për sigurimin e padisë që do të ngrihet apo është ngritur para gjykatës së arbitrazhit. Gjykata merr në shqyrtim kërkesën e paraqitur, dhe shprehet me vendim për të.*"

diskutim në rastin konkret është nëse marrëveshja për arbitrazhin ndërkombëtar midis palëve përcakton një juridiksion ekskluziv dhe përjashtues të gjykatës së arbitrazhit në raport me gjykatën shtetërore apo konkurrues, në lidhje me masat e sigurimit të padisë.

14. Për të njëjtat arsye sikur u parashtruan më lart, Kolegji vlerëson se edhe konkluzionet e gjykatës së shkallës së parë për interpretimin e nenit 204 të Kodit të Procedurës Civile dhe përjashtimin nga zbatimi i ligjit për të drejtën ndërkombëtare private, janë të pabazuara në ligj.

15. Për rrjedhojë, për të gjitha arsyet e dhëna më lart, vendimi i gjykatës së shkallës së pare duhet të prishet dhe çështja duhet të kthehet për rigjykim në po atë gjykatë dhe para të njëjtit trup gjykues.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenin 63 të Kodit të Procedurës Civile,

V E N D O S I

Prishjen e vendimit nr. s’ka, datë 06.08.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dërgimin e çështjes pranë asaj gjykate për vazhdimin e gjykimit.

Tiranë, më 27.12.2018